



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.34/2018

Prishtinë, më 22 tetor 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviq, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla, Fisnik Ismaili, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Mirjeta Kalludra dhe Saranda Bogujevci.

Pjesëmarrës të tjerë: Leutrim Morina-KDI, Shkendije Bikliqi-KTV, Artiana Matoshi-RTK, Besiana Dauti-ekonomia online, Arta Dehari- GP VV, Flora Kryeziu-UNICEF, Ardian Klaiqi-UNICEF dhe Arta Berisha-GPLVV.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Luljeta Veselaj-Gutaj, propozoi që në rendin e ditës në këtë mbledhje të hyjë si pikë me nr. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, propozoi ky të cilin e miratuan anëtarët e Komisionit,

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga Diskriminimi;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10 shtator 2018, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Duda Balje, kryetare, tha se Projektligji për mbrojtjen e fëmijës, është miratuar në parim dhe tani duhet të vendosim se si të punojmë më tutje në këtë projektligj duke shtuar se vullneti i anëtarëve të komisionit është që të punojmë të gjithë, në shqyrtimin e këtij projektligji. Ajo tha se do të angazhohemi për organizimin e një punëtorie. Pasi këtu e kemi të pranishëm edhe UNICEF-in, ndoshta do të mund t'na ndihmojnë në organizimin e punëtorisë.

Teuta Haxhiu, tha se jemi të interesuar që në këtë projektligj të punojmë të gjithë dhe të japim kontributin tonë që të kemi një ligj sa më të mirë, në interes të mbrojtjes së fëmijëve. Ajo tha se është mirë të fillohet me mbajtjen e një punëtorie dhe aty të punohet në mënyrë intensive dhe beson në mbështetjen e partnerëve të Komisionit, sepse është shumë e nevojshme, që ky ligj të fillojë së zbatuari sa më parë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se pajtohet me parafolëset, por është mirë të caktohet një udhëheqës i ekipit, në mënyrë që mos të mbesim peng i moscaktimit të datave dhe agjendës për të shqyrtuar këtë projektligj, pasi që edhe ashtu është i vonuar. Është mirë të bëhet një punëtori, por edhe një vizitë studimore, nëse është e mundur, në lidhje me saktësimin e disa çështjeve të caktuara.

Veton Berisha, tha se është mirë që është proceduar ky projektligj dhe se është i interesuar të përfshihet në punën për shqyrtimin dhe amendamentimin e këtij projektligji, pasi që e konsideron si të një rëndësie të veçantë. Është mirë që fillimisht të identifikojmë institucione dhe mekanizma të cilët merren drejtpërdrejt me këtë fushë. MPMS-ja ka departamente dhe drejtori dhe do të mund t'na ndihmojnë shumë duke qenë pjesë e punës tonë.

Lirije Kajtazi, tha se mbajtja e një punëtorie do të kishte peshën më të madhe sepse përqendrimi është më në nivel. Këtë projektligj duhet ta kompletojmë edhe ta bëjmë funksional, sa më parë.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni është për mbajtjen e një punëtorie, për këtë do të kontaktojmë me partnerët mbështetës, si UNICEF-in, OSBE-në, dhe institucionet të tjera, për mbështetje, me qëllim që të kemi të kemi një ligj sa më të mirë për mbrojtjen e fëmijëve. Ajo konstatoi se Komisioni Funkcional më 29.10.2018, do të mbajë dëgjim publik për shqyrtimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga Diskriminimi

Luljeta Veselaj-Gutaj, paraqiti dhe arsyetoi para Komisionit Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ajo arsyetoi dy rekomandimet e paraqitura në Raport.

Ajo në fund ftoi anëtarët e Komisionit ta votojnë raportin me dy rekomandime dhe të procedohet për seancë, në mënyrë që të zëmë afatin që rekomandimi që ka të bëjë me ndarje të buxhetit për plotësimin e pozitive të zyrtarëve, të hyjë në Projektligjin për buxhetin e vitit 2019.

Në diskutim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, morën pjesë deputetët: Teuta Haxhiu, Mexhide Mjaku-Topalli, Lirije Kajtazi dhe Luljeta Veselaj-Gutaj, diskutimet të cilave janë të pasqyruara në evidencat elektronike të administratës së Komisionit.

Kryetarja, në fund të debatit konstatoi se Komisioni FunkSIONAL, miratoi Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga Diskriminimi, me rekomandimet si në vijim:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtje nga Diskriminimi në strategjinë legislative për vitin 2019.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, të parasheh koston financiare për rekrutimin e zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi nga ana e komunave dhe në 5 (pesë) ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku kjo pozitë është e pambuluar, në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi anëtarët e Komisionit se javën e kaluar së bashku me anëtarin e komisionit Shemi Sylja, ishin në një konferencë për personat me aftësi të kufizuara, ku ishin edhe ministri dhe përfaqësuesi i Qeverisë. Nga ajo konferencë kanë dalë disa propozime konkrete dhe ata kanë shprehur dëshirë me qenë të pranishëm edhe në Komision, ku do të jenë të ftuar disa ministra, dhe ku temë e diskutimit do të jetë zbatimi i strategjisë për personat me aftësi të kufizuara.

Shemi Sylja, tha se në këtë konferencë ishin paksa të zhgënjyer me praninë e vogël të njerëzve kompetentë, për këtë çështje dhe çuditërisht nuk pati media. Ai theksoi se mundësisht si Komision, brenda kompetencave tona, t'ju ndihmojmë që ata ti realizojnë sa më shpejt ato kërkesa që i kanë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se e mbështet mbajtjen e takimit me ministrat dhe Forumin Kosovare për Personat me Aftësi të Kufizuara, në lidhje me zbatimin e asaj strategjie.

Teuta Haxhiu, njoftoi anëtarët e Komisionit FunkSIONAL, në lidhje me takimin që është mbajtur në Komisionin për Arsim dhe Organizatën e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ajo tha, se duhet që këto rekomandime që kanë dalë nga këto tryeza ti përcillen secilit deputet në Komision, e pastaj të vendosim mbi bazën e dy parë rekomandimeve dhe të shohim se çfarë hapa të tjerë duhet ndërmarrë, për të mirën e këtyre personave.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni Funkcional më 31 tetor 2018, të ftojë në takim ministrat kompetentë si dhe Forumin Kosovarë për Persona me Aftësi të Kufizuar, në lidhje me zbatimin e Strategjisë Nacionale për Personat me Aftësi të Kufizuar 2013-2023.

Sasha Milosavljeviq, foli lidhur me një ngjarje që kanë ndodhur para pak ditësh në Komunën e Istogut, ku disa persona janë sulmuar dhe nuk janë lejuar të vizitojnë tempullin e tyre.

Ai theksoi se beson se janë shkelur të drejtat e njeriut. Për këtë ngjarje kanë folur Presidenti dhe Kryeministri i Kosovës, dhe edhe ne si Komision për të Drejtat e Njeriut duhet të reagojmë lidhur me këtë çështje dhe të apelojmë tek qytetarët tanë që situata të tilla mos të ndodhin.

Lirije Kajtazi, tha se rasti që ka ndodhur para pak kohe me sulmin ndaj dy të rinjve shqiptarë, rasti i sulmit të dy autobusëve me pasagjerë shqiptarë në Serbi, si dhe sulmi që ka ndodhur këtu janë raste jo të mira dhe na dëmtojnë të gjithëve, dhe për të qenë së bashku nëse reagohet duhet të përfshihen të gjitha këto raste të cilat janë të dëmshme dhe nuk i kontribuojnë stabilitetit të vendeve tona.

Teuta Haxhiu, tha se rastet e tilla nuk i bëjnë nderë askujt. Rasti i fundit në Istog është dënuar prej institucioneve më të larta të Kosovës, ndërsa dy rastet e tjera që kanë ndodhur në Serbi nuk janë dënuar. Ajo tha se pajtohem me parafolësen që nëse reagojmë, atëherë ne duhet ti dënojmë të gjitha këto raste që kanë ndodhur kohëve të fundit.

Shemsi Sylja, tha se aktet e tilla janë të dënueshme ku cenohet liria e lëvizjes. Ne duhet të dimë se kemi kaluar përmes një lufte të tmerrshme dhe në momente të caktuar mund të çojnë edhe deri te ngritja e emocioneve dhe të bëhen edhe akte të tilla, që për neve nuk janë të kapshme.

Sasha Milosavljeviq, tha se dua të jem i qartë, nuk kam menduar se duhet të dënohen vetëm aktet të cilat ju ndodhin serbëve. Thelbi i çështjes është që në mënyrë të barabartë të shihen të gjitha aktet të cilat nuk janë të drejta dhe të gjitha aktet që janë negative të kryera nga kushdo qoftë. Andaj pajtohem me të gjithë juve që duhet të shikojmë në mënyrë të barabartë të gjitha këto akte të cilat po ndodhin dhe që të gjitha të dënohen në mënyrë të njëjtë.

Veton Berisha, tha se pajtohet që të dënohet secili akt i tillë dhe ngjarjet e tilla u japin të kuptojnë krerëve shtetërorë, të dy palëve se është shumë e nevojshme një marrëveshje paqësore dhe raste të tilla të mos ndodhin.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se pajtohem që si Komision t'i dënojmë aktet e tilla kudo që ndodhin, por tha se ka një pyetje për kolegun Sasha Milosavljeviq, se, si deputet, si grup parlamentar apo si qytetar a ka reaguar dhe dënuar aktet e tilla që kanë ndodhur ndaj shqiptarëve në Serbi, përfshirë rastin e 18 vjeçarit të pafajshëm.

Sasha Milosavljeviq, duke u përgjigjur në pyetjen e deputetes Veselaj-Gutaj, tha se në parim i dënoj të gjitha ngjarjet e tilla, pavarësisht se ku ato ndodhin dhe pavarësisht përkatësisë etnike dhe të tjera.

Ne duhet të krijojmë një vetëdije të tillë te të gjithë qytetarët që ngjarjet e tilla, siç ishte ajo në Novi Sad, ndaj të riut shqiptar si dhe ajo në Komunën e Istogut që në të ardhmen mos të përsëriten asnjëherë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se, para pak ditësh me grupin e grave deputete, ishin në veriun e Mitrovicës , në Novo Bërdë, dhe kanë biseduar me qytetarët atje duke parë edhe problemet me të cilat ballafaqohen. Ajo ftoi për një punë të përbashkët, për të mirën e tyre dhe është mirë të mendojmë arsyeshëm, si qytetarë të Republikës së Kosovës.

Fisnik Ismaili, tha se ngjarja që ka ndodhur me dy të rinjtë shqiptarë në Serbi, a është ngritur në Komision. Nëse të gjitha çështjet ngritën dhe trajtohen në mënyrë të njëjtë, atëherë, kjo do të ishte në rregull.

Kryesimin e mbledhjes e mori nënkryetarja Lirije Kajtazi.

Teuta Haxhiu, ngriti çështjen, në lidhje me Komplexin Memorial në Meje, duke konstatuar se është mirë të kërkojmë nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekse Memorialë të Kosovës, që të na sjellin përgjigjeje me shkrim lidhur me rastin.

Shemsi Syla, tha se kur ishim në vizitë, pamë se ishte shqetësuese çështja e kompleksit në Meje. Ne morëm premtime nga kryetari i Komunës atje se do të ec kjo punë. Kërkoj që të vijë sa më shpejt raporti i Komisionit hetimor për këtë çështje, se çka ka ndodhur dhe drejtori i Agjencisë të jetë prezent në mbledhje, për të mësuar se çka ka ndodhur dhe të ndërmarrim hapa sa më shpejt.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është mire të kemi me shkrim një raport nga drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë dhe një informatë nga procedura gjyqësore, derisa e dimë që Kryeministri ka ftuar publikisht prokurorinë të hetojë rastin e ndërtimit të Komplexit Memorial në Meje.

Lirije Kajtazi, tha se nga ajo që u tha këtu, është e nevojshme të kemi një raport nga drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë dhe një informatë nga prokuroria se ku ndodhet procedura në lidhje me këtë lëndë.

Ajo i njoftoi anëtarët e komisionit se ka filluar java për të drejtat e viktimave të krimit, me moton: Drejtësi për viktimat, ndëshkim për kryerësit, e që është edhe preokupim yni dhe është mirë të angazhohemi edhe në këto aktivitete.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje